



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.5 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20, paragrafi 11 i Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.12.2016, mori këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë konkurrimi.
- II.** Prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: parcela kadastrale, nr. 633-0, Zona kadastrale Matiçan, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 20,049 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 11 m², e evidentuar si pasuri shoqërore – Komuna e Prishtinës.
- III.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përkshuar në pikën II të këtij vendimi, është për periudhën afatshkurtër për 15 vjet.
- IV.** Prona e paluajtshme komunale e përkshuar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- V.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VI.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përkshuar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.

- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.
- VIII.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica gjeodezike.
- IX.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 046-295896, më 06.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dpl.